



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
<b>REKTORATI</b>			
Nr. / Br. / No.	040	Nr. i faq/ Eri. str / No. pg	7
Data / Datum / Date:	09 / 01 / 2024	Pejë / Peë	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

---

## RREGULLORE PËR MOBILITETIN (LËVIZSHMËRINË) E BRENDSHËM TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"

JANAR 2024

Në bazë të dispozitës së nenit 42, 47, 48 dhe nenit 151 paragrafi 1, 2, 3, 4, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" me datën 09.01.2024 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MOBILITETIN (LËVIZSHMËRINË) E BRENDSHËM TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"**

### **Terminologjia dhe koncepti i rregullores**

- **Lëvizshmëria (Mobiliteti) e brendshme (interne)** e studentëve në UHZ përfshin procesin e lejuar dhe të kontrolluar për studentët, për mundësinë e ndjekjes së lëndëve të integruara nga një program i një njësie akademike në një njësi tjetër akademike. Ky proces është një mundësi për studentët që janë të regjistruar në një program të caktuar të studimeve universitare për të ndryshuar ose për të zgjedhur lëndë të caktuara, vetëm në bazë të pritjeve mësimore, brenda të njëjtës njësi akademike ose një njësie tjetër brenda universitetit.
- **Mobiliteti (lëvizshmëria) ndërkombëtar i studentëve** nënkupton lëvizshmërinë ndërkombëtare të studentëve, të cilët janë individë që kalojnë fizikisht një kufi ndërkombëtar ndërmjet dy vendeve me objektivin për të marrë pjesë në aktivitete arsimore në vendin e destinacionit, ku vendi i destinacionit të studentit është i ndryshëm nga vendi i tyre i origjinës.
- **Lëvizshmëri horizontale.** I referohet mundësisë së studentit për të zgjedhur lëndë në vitin dhe semestrin në të cilin është duke i vijuar ligjëratat;
- **Lëvizshmëri vertikale.** I referohet mundësisë së studentit për të zgjedhur lëndë në vitin dhe semestrin akademik në të cilin ai nuk është duke i vijuar ligjëratat, i cili nënkupton vitin paraprak ose vitin pasues;
- **Lëvizshmëri për lëndë jashtë programore.** I referohet mundësisë së studentit për të zgjedhur lëndë që janë jashtë programit të studimit e të cilat evidentohen në shtojcën e diplomës si ECTS kredi, gjegjësisht shkathitësi shtesë pa e ndryshuar nivelin dhe shkallën e studimit.
- **Kurrikula:** kurrikula është programi mësimor me anën e të cilës studentët arrijnë qëllimet, ideat dhe aspiratat e tyre profesionale.
- **Kurrikulë e integruar:** Në kuptim të kësaj rregulloreje kurrikulë e integruar kuptohet tërësia e të gjitha programeve në të dy nivelet e studimit (BSC dhe MA ose MSC) dhe theksi qëndron në marrëdhënien ndërmjet lëndëve/disiplinave të ndryshme.
- **Studentë,** janë studentët e të gjitha njësive akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" në nivelin e parë dhe të dytë dhe formave të tjera të studimit.
- **Avancimi në karrierë:** i referohet procesit të zgjedhjes së një rruge kariere duke përmirësuar ekspertizën dhe duke punuar për mësim afatgjatë. Kurrikula e integruar dhe vetëdizajnimi i diplomës do të ndihmojë studentët në përmirësimin e perspektivave të tyre në karrierë.
- **Personalizimi i të mësuarit:** përfshin konceptin e dizajnit të diplomës nga studenti duke krijuar mundësi që ajo të personalizohet për të pasqyruar dëshirat, interesat, dhe identitetin. Kjo e bën diplomën më të veçantë dhe të përputhshme me interesin e studentit.
- **Të mësuarit kreativ:** Është ndërtimi i njohurive dhe zhvillimi i aftësive në mënyrë kreative. Këtu përfshihet edhe vetëdizajnimi i diplomës. Ky proces u jep studentëve mundësinë për të shprehur kreativitetin e tyre.

## Neni 1

### QËLLIMI

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë lëvizshmërinë e studentëve në universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, për rritjen e efikasitetit të mësimnxënies dhe krijimit të mundësisë për profilizim të studentëve.

## Neni 2

### FUSHËVEPRIMI

**Rregullorja për lëvizshmëri të brendshme fokusohet në:**

1. Lëvizshmërinë, të lidhur ekskluzivisht për qëllime studimi;
2. Profilizim të studentëve lidhur me arritjet në kuadër të profesionit, brenda programeve që ofrojnë njësitë akademike të UHZ -së
3. Individualizim, gjegjësisht vetdizajnimin e profilit dhe fitimin e shkathtësive;
4. Përforsim i fushës së ndërmarrësisë në të gjitha segmentet programore;
5. Lëvizshmërinë (mobilitetit) mësimore të studentëve të UHZ -së, si një mundësi për të zhvilluar aftësi dhe zgjerim të horizonteve të dijes së tyre duke lëvizur dhe studiuar brenda programeve të UHZ-së ose për të ndërmarrë trajnime në kuadër të këtyre programeve. Përfitimet e lëvizshmërisë njihen zyrtisht;
6. Mundësinë për lëvizshmëri të brendshme për të realizuar shkëmbimin e hapur të talenteve dhe ideve brenda universitetit.

## Neni 3

### POLITIKAT E UHZ – SË PËR SIGURIMIN E LËVIZSHMËRISË (MOBILITETIT) TË BRENDSHËM

1. Politikat e universitetit për të siguruar lëvizshmërinë e brendshme të studentëve janë të rëndësishme për të ndihmuar studentët të zgjedhin lëndë zgjedhore në kuadër të një programi studimi në një lëndë tjetër brenda të njëjtit institucion.
2. Këto politika duhet të jenë të qarta, të drejtpërdrejta dhe të ndjekura me kujdes.
3. Disa nga elementët kryesorë që duhet të përfshijnë politikat e lëvizshmërisë së brendshme janë:
  - 3.1. **Transferimi i kredive:** Politikat e universitetit duhet të përcaktojnë se si do të transferohen dhe përshtaten kreditë e lëndës së zgjedhur nga studentët për lëvizshmëri të brendshme në programin e studimit të tyre. Kjo përfshin rregullat për vlerësimin e kredive dhe transferimin e tyre.
  - 3.2. **Procedurat e orientimit dhe mbështetjes:** Universiteti duhet të ofrojë procedura të qarta për orientimin dhe mbështetjen e studentëve të rinj të cilët dëshirojnë të kryejnë lëvizshmëri të brendshme nga një fakultet në një tjetër dhe në përcaktimin e lëndëve për lëvizshmëri. Kjo mund të përfshijë takime individuale me këshilltarë akademikë dhe sesione informuese për të ndihmuar studentët të integrohen në lëndën e re dhe të kenë informatat e duhura për lëvizshmërinë e brendshme.
  - 3.3. **Proceset e monitorimit vlerësimit, dhe përmirësimit:** Universiteti duhet të ketë procese të përditësuara për monitorimin, vlerësimin e politikave të lëvizshmërisë së brendshme dhe për përmirësimin e tyre sipas nevojës.
4. Politikat e lëvizshmërisë së brendshme duhet të jenë transparente, të drejtpërdrejta dhe të zbatohen në mënyrë konsistente. Kjo do të ndihmojë studentët të fitojnë përvojë për dhe do të lehtësojë procesin e lëvizshmërisë së tyre brenda universitetit.

## Neni 4 LËVIZSHMËRIA NË LËNDËT E OBLIGUESHME

1. Nëse lënda e njëjtë ofrohet nga dy ose më shumë njësi akademike me ECTS kredi të njëjta nga profesorë të brendshëm, studentit i ofrohet e drejta e përzgjedhjes së njësisë akademike ku dëshirojnë ta ndjekin lëndën:
  - 1.2 **Përputhja e ECTS kredive:** studentët duhet të sigurohen që numri i ECTS kredive për lëndën që zgjedhin në njësinë tjetër akademike, përputhet me ECTS kredive të plan programit mësimor të njësisë të tyre akademike. Kjo do të thotë që numri i ECTS kredive për lëndën duhet të jetë i barabartë ose më i madh se numri i ECTS kredive të obliguar me programin e tyre të studimit;
  - 1.2 **Suplementi i diplomës:** Nëse studenti ka marrë lëndë që tejkalojnë numrin e ECTS kredive të obliguara, ECTS kreditë shtesë duhet të jenë të dokumentuara dhe të përfshira në shtojcën e diplomës së studentit.

## Neni 5 KËSHILLI PËR KURRIKULË DHE STUDIME TË INTEGRUARA

1. Këshilli për kurrikulë dhe studime të integruara, themelohet nga Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe përbëhet nga:
  - 1.1. Prorektori për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkimeve shkencore është anëtar ex-officio;
  - 1.2. Prodekanët për mësimdhënie dhe çështje akademike të 5 njësive akademike;
  - 1.3. Koordinatorët për cilësi të 5 njësive akademike;
  - 1.4. Kryesuesin e këtij këshilli e emëron Senatin, për një mandat 4 vjeçar;
  - 1.5. Në rast se ndonjëri nga anëtarët jep dorëheqje, pezullon marrëdhënien e punës, ndryshon pozicion apo për çfarëdo shtate tjetër nuk mund të jetë anëtar i KKSI, Senati e zëvendëson në mbledhjen radhës;
  - 1.6. Zyrtarin përgjegjës i cili ka për obligim që të përkujdeset për sekretarinë e KKSI, e cakton Senati i Universitetin në mbledhjen e themelimit të KKSI.

## Neni 6

### DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT PËR KURRIKULË DHE STUDIME TË INTEGRUARA TË UHZ – SË

1. Këshilli për Kurrikulë dhe Studime të Integruara (më tutje **KKSI**) është autoriteti qendror i dizajnit, ruajtjes së ekuilibrit të programit dhe zbatimit të metodologjisë së lëvizshmërisë së brendshme në përputhje me kurrikulën integruar në Universitetin "Haxhi Zeka";
2. **KKSI** – ja, gjatë veprimtarisë së vet duhet të ketë parasysh një gamë të gjerë parimesh të cilat, në përgjithësi mund të grupohen në katër kategori:
  - 2.1. suksesin e studimeve;
  - 2.2. rritjen e kompetencave;
  - 2.3. ndryshimet e vlerave dhe qëndrimeve; dhe
  - 2.4. ndikimet në karrierë.
3. **KKSI**, së paku tre muaj përpara përpunon dhe ia paraqet Senatit të UHZ -së për miratim planin zbatues të modaliteteve për lëvizshmërinë e studentëve në lëndë brenda programeve në UHZ;
4. Plan-programi zbatues është i detyrueshëm për të gjitha njësitë akademike të UHZ -së;
5. Në kuadër të aktivitetit të vet **KKSI** përcakton me sa vijon:
  - 5.1. Caktimin e momentit kohor për lëvizshmëri;
  - 5.2. Identifikimin e lëndëve të cilat janë të mundshme të zgjedhën nga studentët në procesin e lëvizshmërisë së brendshme të lidhur me qëllimet e studimit;

- 5.3. Pragun minimal dhe maksimal të lëndëve për lëvizshmëri;
- 5.4. Përcaktimin e llojit të lëndëve të cilat mund të jetë pjesë e zgjedhjes së studentëve për lëvizshmëri;
- 5.5. Përcaktimin e lëndëve/ECTS kreditë për lëvizshmërinë e brendshme.

#### **Neni 7**

#### **KOMISIONET PËR LËVIZSHMËRI TË BRENDSHME**

KKSI themelon komisionet ad-hoc, si në vijim:

1. Komisioni ad hoc për hartimin e syllabusëve për lëndët në kurrikulë të integruar.
2. Komisioni për monitorim, vlerësim dhe përmirësim të procesit të lëvizshmërisë së brendshme.

#### **Neni 8**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E SYLLABUSËVE PËR LËNDËT NË KURRIKULË TË INTEGRUAR**

1. Të hartojë syllabusët për lëndët në kurrikulë të integruar konform standardeve të UHZ-së dhe AKA-së.
2. Të analizojë programet e studimit dhe të propozojë lëndët që janë të përshtatshme për t'u vendosur në kurrikulën e integruar.
3. KKSI, me rastin e themelimit të këtij komisionit mund të vendosë edhe detyra të tjera pos këtyre që janë të parapara në paragrafët e sipërhënuar.

#### **Neni 9**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KOMISIONIT PËR MONITORIM, VLERËSIM DHE PËRMIRËSIM TË PROCESIT TË LËVIZSHMËRISË SË BRENDSHME**

1. Të analizojë procesin e lëvizshmërisë së brendshme, të ofrojë rekomandime për përmirësimin e procesit.
2. Të monitorojë procesin e lëvizshmërisë së brendshme;
3. Të vlerësojë procesin e lëvizshmërisë së brendshme;
4. T'i ofrojë rekomandime KKSI, mundësitë për përmirësimin e vlerësimit dhe monitorimit të procesit të lëvizshmërisë së brendshme.
5. KKSI, më rastin e themelimit të këtij komisionit mund të vendosë edhe detyra të tjera pos këtyre që janë të parapara në paragrafët e sipërhënuar.

#### **Neni 10**

#### **TË DREJTAT E STUDENTËVE PËR LËVIZSHMËRI**

1. Studenti/ja i një njësie akademike në UHZ ka të drejtë të jetë subjekt i procesit të lëvizshmërisë (mobilitetit) të brendshëm brenda frymës së qëllimeve të kësaj rregulloreje.
2. Studenti/ja ka të drejtë të marrë pjesë në lëvizshmërinë e brendshme që nga semestri i parë i studimeve themelore (BSC).
3. Këto të drejta ndihmojnë në garantimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës së procesit të lëvizshmërisë. Disa nga të drejtat kryesore të studentëve në këtë kontekst përfshijnë:
  - 3.1. **Informacioni i plotë dhe i qartë:** Studentëve u jepet e drejta për informacion të plotë dhe të qartë rreth procesit të mobilitetit të brendshëm.
  - 3.2. **Njohja e kredive:** Studentët kanë të drejtë që të grumbullojnë edhe më shumë ECTS kredi nga sa janë paraparë në programin e tyre të studimit.

- 3.3. **Ndihmë dhe mbështetje logjistike:** Administrata e njësisë akademike ofron ndihmë dhe mbështetje për studentët që kanë zgjedhur të përfshihen në lëvizshmërinë e brendshme duke ju ofruar asistencë dhe shërbime të tjera praktike.
- 3.4. Shërbime të tjera të nevojshme për lëvizshmëri të brendshme.

#### Neni 11

#### **OBLIGIMET E STUDENTIT PËR TË QENË PJSË E LËVIZSHMËRISË (MOBILITETIT) TË BRENDSHËM**

1. **Respektimi i rregullave dhe procedurave të universitetit:** Studentët duhet të njohin dhe të ndjekin rregullat, procedurat dhe politikat e universitetit në lidhje me lëvizshmërinë e brendshme.
2. **Monitorimi dhe komunikim i rregullt:** Studentët duhet të komunikojnë dhe ta marrin informata nga administrata e njësisë akademike përkatëse rreth lëndëve për lëvizshmëri të brendshme, ECTS kredive dhe çdo informatë tjetër.

#### Neni 12

#### **DETYRIMET E NJËSIVE AKADEMIKE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR LËVIZSHMËRINË E BRENDSHME**

1. Fakultetet, si në planin akademik e posaçërisht atë administrativ, kanë detyrime për të siguruar zbatimin e programit të lëvizshmërisë së brendshme të studentëve në mënyrë që të ofrojnë përvojë të arsimit të lartë cilësore dhe të përshtatshme për nevojat dhe synimet e tyre.
2. Fakulteti ka përgjegjësinë e sigurimit të një mjedisi të lehtësuar për studentët që janë duke zgjedhur lëndët e studimit për lëvizshmërinë e brendshme dhe për t'i ndihmuar ata në realizimin e synimeve të tyre akademike dhe karrierë.
3. Detyrime dhe përgjegjësi të fakultetit përfshijnë:
  - 3.1 **Informacioni dhe këshillimi:** Fakulteti siguron informacion të qartë dhe të plotë për studentët rreth mundësive për lëvizshmërinë e brendshme. Kjo përfshin informacion rreth mundësive të përzgjedhjes së lëndëve nga programe të tjera studimi. Një komponent kyç është këshillimi individual i studentëve për të ndihmuar ata në planifikimin e mobilitetit të tyre.
  - 3.2 **Njohja e kredive:** UHZ ka sistemin e tij elektronik për njohje të ECTS kredive të lëndëve të zgjedhura për lëvizshmërinë e brendshme.

#### Neni 13

#### **DETYRIMET E ADMINISTRATËS QENDRORE TË UHZ -SË**

1. Administrata qendrore e UHZ -së ka detyrimet dhe përgjegjësitë e saj për sigurimin e lëvizshmërisë së brendshme të studentëve në mënyrë efektive dhe të drejtë.
2. Detyrimet e administratës qendrore në kuadër të këtij procesi përfshijnë:
  - 2.1. **Zbatim i politikave dhe rregullave:** Administrata qendrore duhet të rregullojë çështjet që ndërlidhen me njohjen e ECTS kredive të fituara gjatë lëvizshmërisë së brendshme. Procedurat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme, dhe në përputhje me standardet e institucionit.
  - 2.2. **Përpunim i shpejt i aplikimeve:** Është e rëndësishme që administrata të përpunojë aplikimet për lëvizshmërinë e brendshme me shpejtësi dhe të sigurojë që studentët të kenë përgjigje në një periudhë të arsyeshme.
  - 2.3. **Këshillim dhe mbështetje studentëve:** Administrata duhet të ofrojë këshillim dhe mbështetje për përshtatshmërinë e kurseve të zgjedhura me priltjet mësimore të programit.
3. Administrata qendrore ka detyrimin e sigurimit të një mjedisi të lehtësuar dhe të mbështetjes së studentëve në procesin e lëvizshmërisë së brendshme. Përmirësimet në procedurat dhe shërbimet e ofruara mund të ndihmojnë në përmirësimin e përvojës së

studentëve dhe në inkurajimin e tyre për të eksploruar dhe përfituar më shumë nga resurset e universitetit.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14**

#### **Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.

### **Neni 15**

#### **HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati.

Kryesues i Senatit



Prof. Dr. Armand Krasniqi  
Rektor i UHZ-së

